



Fillimi > -Kronikë

Armë, municione e drogë, pranga 3 të rinjve në Durrës

17 Mars, 2020 08:57 |



Madhësia e tekstit: - +

Policia e Durrësit ka goditur dy raste të veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje, ndërkohe qe ne pranga 3 persona.



Keshtu, ne kuader te operacionit policor “Bashkëpunimi”, u sekuestruan armë, municion luftarak, drogë, makineri përpunimi të lëndës narkotike, një automjet, targa automjetesh dhe një sasi parash e përfituar nga shitja e lëndës narkotike.

NJOFTIMI I POLICISE

Vihen në pranga tre shtetas si dhe procedohen penalisht tre të tjerë.

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, falë bashkëpunimit me qytetarët, kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Bashkëpunimi”, në kuadër të të cilit u godit një rast i armëmbajtjes pa leje dhe një rast i shpërndarjes së lëndëve narkotike në doza të vogla.

Në kuadër të operacionit Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Durrës, vunë në pranga shtetasin K. L., banues në Durrës, të cilit gjatë kontrollit ju gjet dhe ju sekuestrua një armë zjarri kallashnikov dhe një sasi municioni luftarak

Operacioni ka vijuar nga Specialistët e Seksionit Për Hetimin e Narkotikëve ne Drejtorinë e Vendore te Policisë Durrës, ku falë bashkëpunimit me qytetarët dhe ndjekjes me metoda speciale të hetimit në kuadër të procedimit penal të vitit 2020 u godit një tjetër rast i shpërndarjes së lëndëve narkotike në doza të vogla.

Si rezultat u vunë në pranga shtetasit D. Rr.24 vjeç dhe S.P, 23 vjeç, të dy banues në lagjen nr.13 Plazh – Durrës, si dhe u proceduan penalisht shtetasit XH.B, 24 vjeç, S.N, 30 vjeç, i dënua me pare për vjedhje dhe armëmbajtje pa leje, dhe V.M 35 vjeç.

Ne zonën e Plazhit të qytetit Durrës, Specialistët për Hetimin e Narkotikëve gjatë kontrollit në automjetin e shtetasit XH.B, gjetën dhe sekuestruan dy grirëse të lëndës narkotike që shërbejnë për përgatitjen e saj në doza dhe një palë targa, si dhe gjatë kontrollit fizik të shtetasit S.P, gjetën dhe sekuestruan 18.5 gramë lëndë narkotike kanabis e ndarë në doza dhe një sasi parash të dyshuara të përfituara nga shitja e lëndës narkotike.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës se Shkalles se Pare Durrës për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kryer në bashkëpunim”.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)


Etiketa: arme Durrës pranga

TË NGJASHME



Balluku inspekton masat: Anijeve puna me përpunimin e anijeve tregtare, 60% e produkteve ushqimore futen nga Porti i Durrësit

02 Prill, 2020



OST njofton abonentët në Durrës: Nesër më 3 prill do stakohet energjia në këto zona

02 Prill, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



"Arkivimi i çështjeve, efekte të pariparueshme", Klodiana Lala: Paralizimi i drejtësisë nga COVID, pasoja në të ardhmen. Rrezikohen afatet e paraburgimit

02 Prill, 2020



Zbulohet me letra makine false dhe me cigare kontrabandë pas kontrollit në port, procedohet penalisht 39-vjeçari

02 Prill, 2020



Falsifikonin dokumente dhe kryenin trafik njerëzish drejt SHBA, Kanadasë e Mbretërisë së Bashkuar, përfundojnë hetimet për 17 të akuzuarit

02 Prill, 2020




SPAK publikon emrat e 17 anëtarëve të grupit kriminal, trafikonin qytetarë drejt SHBA-së, Kanadasë e Anglisë me viza false

02 Prill, 2020



"Nuk e meritoje këtë pabesi", postimi prekës i mikut të ngushtë për 29-vjeçarin që vdiq në aksident: Iu luta Zotit të ishte shaka 1 Prilli!


02 Prill, 2020



"Laboratori Intermedica" analiza falas për të prekurit me koronavirus, mjeku: Përgjigjja do dalë për 1 orë, mund të vijojmë dhe në maj


02 Prill, 2020

KATEGORIA VIDEO



Deklaratat në kohën e koronavirusit/ Vasili nxjerr videon: Me fat Kosova me Albinin, fatkeqe Shqipëria me Ramën që ndjell vetëm zi!

02 Prill, 2020



VIDEO/ I gjejnë test shtatzënie, dy djemtë dhunojnë barbarisht me grushte e shkelma vajzën

02 Prill, 2020




Ish-deputetja e PD sjell dëshmitë e qytetarëve: Ja si e rrëzojnë propagandën e shëmtuar të Ramës

02 Prill, 2020




"Gruaja shqiptare se askush tjetër", ja çfarë bën Emina Cunmulaj për bashkëshortin (Video)

02 Prill, 2020



"Gjuha e urrejtjes së Xhaçkës zbulon se po fshehin skandalin", Alibeaj: SPAK dhe Prokurori i Përgjithshëm të lënë karantinën, të nisin hetimin për tenderin e ushqimeve

02 Prill, 2020



Alessandra Ambrosio poston foto me bikini për fansat e saj

02 Prill, 2020